Si nëpër filma! Trafikanti 'kapet' mat duke fjetur në 'shtëpinë e barit', pamjet nga aksioni i policisë në Shkodër

18 Tetor, 2023 10:04

Madhësia e tekstit:

Pamjet që shihni tregojnë aksionin e Policisë së Shkodrës, në një 'shtëpi bari' në fshatin Trush i Poshtëm të Bushatit.

Forca policore të maskuara dhe të armatosura, kanë hyrë befasisht në banesën e kthyer në një strehë të kultivimit të kanabisit përmes llambave, ndërkohë kanë kapur mat një prej trafikantët që kujdesej për drogën.

"Nga këqyrja e ambienteve të banesës, përveç bimëve narkotike të kultivuara në vazo, u konstatua një sistem i përparuar elektrik dhe kondicionimi, i cili ishte i montuar në të katërta dhomat e banesës dhe në hyrje të saj. Në momentin e ndërhyrjes nga ana e shërbimeve policore, në banesën e përshtatur si laborator, u kap në flagrancë duke u kujdesuar për bimët narkotike, shtetasi Lorenc Trieshi, 34 vjeç, banues në Fushë Kuqe, Kurbin.

Po nga këqyrja e banesës u konstatua se kishte lidhje të paligjshme të energjisë elektrike, që shërbente për furnizimin e pajisjeve elektrike që përdoreshin për kultivimin e bimëve narkotike. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 82 llamba dhe aparate të ndryshme elektrike, 5 aspiratorë, si dhe u morën për ekspertim 123 bimë narkotike që ishin kultivuar në vazo. Gjithashtu, nga kontrolli përreth banesës, në një ambient tjetër të përshtatur për tharjen e bimëve narkotike, u gjetën 2 mjete lundruese tip "Jet Ski", pa dokumentacion.

Nga veprimet e shpejta në vendngjarje, u bë i mundur identifikimi i autorëve të kësaj veprimtarie kriminale, konkretisht shtetasit: Dedë Laca, 64 vjeç dhe djali i tij Anton Laca, 36 vjeç, të cilët u kapën menjëherë dhe u ndaluan nga shërbimet e Policisë. Nga hetimet rezultoi se shtetasi i kapur në flagrancë në banesën e përshtatur, Lorenc Trieshi, është nipi i shtetasit Dedë Laca. Në përfundim të hetimeve paraprake u bë arrestimi në flagrancë i këtyre 3 shtetasve, për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Vjedhja e energjisë elektrike", të kryera në bashkëpunim.

Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e organizatorëve të kësaj veprimtarie kriminale, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri kallashnikov me 2 karikatorë me fishekë, 1 armë gjahu sportive, 2 automjete, tip "Range Rover" dhe tip "Benz", prodhime të viteve të fundit. Në vijim të operacionit u shoqëruan në ambientet e Policisë, kryetari i fshatit Trush i Poshtëm, shtetasi K. D., 38 vjeç, lexuesi i matësve elektrikë në zonë, shtetasi Z. N., 26 vjeç, si dhe elektricisti i zonës, shtetasi F. H., 29 vjeç, ndaj të cilëve u referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës".", thuhet në njoftim.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Droge Shkoder

TË NGJASHME

Kishin kthyer banesën në 'shtëpi bari', në pranga babë e bir dhe nipi në Shkodër. Sekuestrohen dhjetëra bimë narkotike, dy 'Jet ski' dhe armë
18 Tetor, 2023

Droga pranë shkollave, Balla: Policia po ndjek këmba-këmbës keqbërësit, 27 të arrestuar e proceduar në pak ditë
16 Tetor, 2023

Taboola Feed

"I thashë, Edi je i çmendur?!", koreografi zbulon prapaskenën pas kërcimit që mbërtheu liderët e BE-së
"I thashë, Edi je i çmendur?!", koreografi zbulon prapaskenën pas kërcimit që mbërtheu liderët e BE-së
balkanweb.com

Jobs In Canada
Find Applying for work in canada. Search
Jobs | Sponsored
Click Here

This mineral will melt your belly fat fast
well-being-review DietDrops | Sponsored

Billionaire Divorced His 19 Year Old Wife, He Is Shocked When His Wife Says This
NFTscores.io | Sponsored

Play this game for 1 minute and see why everyone is addicted.
PanzerRush | Sponsored

Learning Digital Transformation Might Be Easier Than You Think
Search Ads | Sponsored
Search Now

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Seanca për Gërdecin në SPAK/ Pyeten dëshmitarët e parë, debate mes familjarëve të viktimave dhe avokatëve të Mediut
18 Tetor, 2023

Planifikoi vrasjen e dy prokurorëve, gjykata e Janinës i hap rrugën ekstradimit te Laert Haxhiut
18 Tetor, 2023

EMRI/ Ushtronte profesionin e laborantit dentar pa licencë brenda në banesë, por iu kap dhe drogë, pranga 40-vjeçarit në Fier
18 Tetor, 2023

Sherr mes dy 15-vjeçarëve në Shkodër, njëri prej tyre plagoset me thikë
18 Tetor, 2023

Panik në mjediset e bashkisë së Fushë Arrëzit, i riu tenton të vetëdigjet me benzinë
18 Tetor, 2023

Gjendet trupi i pajetë i një të moshuari në Devoll, dyshimet e policisë
18 Tetor, 2023

KATEGORIA VIDEO

"Në kabinetin e Ramës ka non-grata", Çollaku: PS marrëveshje me Rithemelimin për rrëzimin e Rezolutës së Kosovës, më thanë se morën urdhër
18 Tetor, 2023

79-vjetori i çlirimit të Lushnjës, Balla: Samiti i Procesit të Berlinit e shndërroi Shqipërinë në Europën e Ballkanit
18 Tetor, 2023

"SPAK duhet të hetojë vetëm korrupsionin e madh", Altin Dumani propozon: Kufiri për çështjet prej 50 mijë lekësh të ngrihet, ka mbingarkesë
18 Tetor, 2023

VIDEO/ Panik në disa aeroporte në Francë, pasagjerët evakuohen pas kërcënimeve për bombë
18 Tetor, 2023

VIDEO/ Studentët e mjekësisë protestojnë para ministrisë së Arsimit, "mbulojnë" godinën me letra higjienike
18 Tetor, 2023

Heqje dorë nga amnistia fiskale për të nxjerrë Shqipërinë nga lista gri? Ja si përgjigjet ministri i Financave
18 Tetor, 2023

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Ekskluzive/ Mediu: Të krijojmë koalicionin mbarëopozitar me logo dhe vulë, të mos përsërisim '14 Majin' në 2025. Agron Duka: S'jam dakord për...
18 Tetor, 2023

Seanca për Gërdecin në SPAK/ Pyeten dëshmitarët e parë, debate mes familjarëve të viktimave dhe avokatëve të Mediut
18 Tetor, 2023

Planifikoi vrasjen e dy prokurorëve, gjykata e Janinës i hap rrugën ekstradimit te Laert Haxhiut
18 Tetor, 2023

Ekskluzive/ Propozimi i Shehut në mbledhjen me dyert të mbyllura: Na ktheni në grupin parlamentar, takimet t'i mbajmë në PD. Berisha: Na ka rënë zjarri në shtëpi, më keq se në '97-ën!
18 Tetor, 2023

Pikantet e miqësores Shqipëri-Bullgari/ Një bilbil gënjen kuqezinjtë, pas fitores ia marrin... valles
18 Tetor, 2023

"Në kabinetin e Ramës ka non-grata", Çollaku: PS marrëveshje me Rithemelimin për rrëzimin e Rezolutës së Kosovës, më thanë se morën urdhër
18 Tetor, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.